



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:064594

Datë: 07.05.2019

Numri i dokumentit: 00301803

P. nr.743/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit H. K. nga fsh.D. K Gjakovë, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358/1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP.nr.568/18 të dt.15.10.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **23.04.2019**, në prani të Prokurorit së shtetit Anton Hasanaj si dhe të akuzuarit H. K. ,të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **H. K.** nga fsh D. K Gjakovë, i biri i A. dhe i nënës H. e gjinisë B., data e lindjes . . . , ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i 3 fëmijëve, nr. ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

- **me datë 05.04.2018, rreth orës 11.00 min.** në vendin e quajtur “. . .“ Njësia . . .,Rajoni Pyjor Pashtriku –Zona . . ., me të cilën menagjon Agjencioni pyjor i Kosovës, me qëllim vjedhje në pyejet shoqerore ka prer dru me sopatë t llojit “Bungu” dhe “Shkozë “me gjatësi prej 3m ,me diametër 5 cm , me vëllim të përgjithshëm prej 4m³,me çka të dëmtuarës Njesisë Pyjrore ne . . .i kishte shkakuta dem material ne shume prej 512.00 euro .

-me çka ka kryer veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358/1 të KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,46,49,50,51, 73 ,neni 358/1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarës i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

I dëmtuari A.P.K.–A. P. K. GJ., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30 ,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.568/18 të dt.15.10.2018, e ka akuzuar të akuzuarin H. K. nga fsh. . . K-Gjakovë, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358/1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.23.04.2019, përfaqësuesi i PTH-DP në Gjakovë , Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , lexoi aktakuzën PP.nr. 568/18 të dt.15.10.2018 dhe deklaroi se mbeti në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari H. K. , në shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion dhe shtojë se këtë vepër e kam kryer për shkak të gjendjes së dobët ekonomike për nevojat familjare mirëpo e kontestojë lartasin e demit të konstatuar nga e dëmtuara me qene se nuk sasia e drunjëve të prerë me sopat nga ana e imë në sasinë e cila është cekur në vëllim prej 4m³ dhe në vëllimin dhe gajësin e cekur si në procesverbalin e të dëmtuarës, andaj i propozoi gjykatës që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , pendimi i shprehur në gjykatë për veprën e kryer , premtimi se në të ardhmen nuk do të përsëritet një gjë e tillë ,gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se me parë nuk kam ra ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit prokurori i shtetit Anton Hasanaj deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorin juridike të pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, por meqenëse në shkresat e nuk kemi ekspertizë mbi sasinë e druve të prerë i propozojë gjykatës që e dëmtuara të udhëzohet në kontest civil.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari H. K.: me datë 05.04.2018, rreth orës 11.00 min. në vendin e quajtur “. . .“ Njësi . . . ,Rajoni Pyjor P. –Zona . . . , me të cilën menagjon Agjencioni pyjor i Kosovës, me qëllim vjedhje në pyejet shoqerore ka prer dru me sopatë t llojit “Bungu” dhe “Shkozë “ me gjatësi prej 3m ,me diametër 5 cm , me vëllim të përgjithshëm prej 4m³,me çka të dëmtuarës Njesisë Pyjrore në . . . i kishte shkakuta dem material në shume prej 512.00 euro

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, Gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit rrethana posaqërisht rënduese nuk gjeti ndërsa prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se është baba i 3 fëmijëve, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte në gjykim, pendimin e tij, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngajshme, kërkim falje nga i demtuari për dëmin e shkaktuar, gjendja e dobët nomike si dhe faktin se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **4 (katër) muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryejnë vepër penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u murr konform nenit 463 par.2 të KPPK-ës pasi gjykata gjatë shqyrtimit fillestar nuk ka mundur të saktësoj sasinë e dëmit që i akuzuari ia ka shkaktuar të dëmtuarit, pasi që nuk ka asnjë ekspertizë apo konstatimi për lartësin e dëmit të shkaktuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.743/18 më datë 23.04.2019**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.